

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aeroporti i Vlorës/ Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s, MIE: Kontrata e koncesionit ka hyrë në fuqi - Infor mohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/perplasja-per-pagat-e-magjistrateve-shoqata-evropiane-e-gjyqtareve-po-c-enohet-shteti-i-se-drejtes/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 15:52:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:45:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9f95e3eb55a49789cbc6f85f06b42a70f00f54d6ccfc60f0ad40a9f4f77c1216
TEKSTI	a8a9d4b6f2ccf330fc67cfe5add2db598e958a5372417c8f965df0449fcf5ea6
PAMJA	05c6d719d528fea4e5331e0e8066abd2e96dfbbf20e8e495ef3ab9a9f5fc5a01

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0f893de81622ad3ee2c546ef89f02f768a41e611d31a59d60c4dd56b7444c9fb
E MËPARSHMJA	5b034500888bca39ea318525ff55ed4ea580ea0659105c39ea3c9c12ce99eb45
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0f893de81622ad3ee2c546ef89f02f768a41e611d31a59d60c4dd56b7444c9fb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


YOU ARE AT: Home » Aeroporti i Vlorës/ Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s, MIE: Kontrata e koncesionit ka hyrë në fuqi

EKONOMI

Demo

Aeroporti i Vlorës/ Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s, MIE: Kontrata e koncesionit ka hyrë në fuqi

SEPTEMBER 17, 2026



Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore të VIA-s, koncesionarit të Aeroportit të Vlorës, duke mos pranuar kërkesën për pezullimin e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit. Lajmi është bërë i ditur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila e konsideron vendimin një fitore të rëndësishme për institucionin.

Sipas njoftimit të MIE, më 16 shtator 2026, Arbitri i Emergjencës ka nxjerrë urdhrin në kuadër të procedurave të arbitrazhit të urgjencës të nisura nga VIA.

MIE bën me dije se nga tri kërkesat e paraqitura nga koncesionari, dy janë rrëzuar tërësisht, ndërsa nuk është pranuar as kërkesa kryesore për pezullimin e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit.

Sipas Ministrisë, Arbitri i Emergjencës ka rrëzuar kërkesën e VIA-s për të pezulluar si zgjidhjen e kontratës, ashtu edhe zbatimin e Njoftimit për Zgjidhje. Në këtë pikë, sipas MIE, arbitri ka vlerësuar se as kontrata dhe as provat e paraqitura nuk ofronin bazë të mjaftueshme ligjore për marrjen e një mase të tillë.

Si rrjedhojë, MIE thekson se zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi.

Arbitri ka rrëzuar gjithashtu kërkesën e VIA-s për të detyruar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi dhe të caktojë një ndërmjetës, si dhe kërkesën për shtyrjen me dy muaj të fillimit të procedurave të arbitrazhit.

Sipas MIE, rrëzimi i këtyre kërkesave i hap rrugë vijimit të menjëhershëm të mosmarrëveshjes përpara tribunalit të arbitrazhit, ku ministria thotë se do të vijojë të mbrojë qëndrimin e saj.

Megjithatë, Arbitri i Emergjencës ka vendosur një masë të përkohshme dhe afatshkurtër për ruajtjen e status quo-së, deri në konstituimin e tribunalit të arbitrazhit dhe shqyrtimin e çështjes prej tij.

Në bazë të kësaj mase, MIE duhet të përmbahet përkohësisht nga ushtrimi i disa të drejtave që lindin pas zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit. Sipas Ministrisë, arbitri ka theksuar se kjo masë është e kufizuar në kohë dhe nuk cenon vlefshmërinë apo efektshmërinë e zgjidhjes së kontratës.

MIE bën me dije gjithashtu se Arbitri i Emergjencës ka urdhëruar VIA-n të përballojë shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të urgjencës.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e interpreton vendimin si një rrëzim të kërkesës kryesore të koncesionarit, i cili synonte të pengonte hyrjen në fuqi të zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit dhe të shtynte fillimin e arbitrazhit përmes një procesi ndërmjetësimi.

Sipas MIE, asnjëra prej këtyre kërkesave nuk është pranuar. Zgjidhja e kontratës nuk është pezulluar,

Postimet e reja

Kontrollet me pajisje
inteligjente në Fier, mbi...

SEPTEMBER 17, 2026

Aeroporti i Vlorës/
Arbitrazhi rrëzon kërkes...

SEPTEMBER 17, 2026

Edi Rama viziton Malin e
Athosit, qëndron gjatë...

SEPTEMBER 17, 2026

Pas vendimit të Hagës për
ish-krerët e UÇK-së,...

SEPTEMBER 17, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

**Kompania e krijuar tri ditë pas
hapjes së thirrjes për grantet e
startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në
fazën e rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare**

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant
2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

**Skema sesi IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që
ju merr konsumatorëve
me interesa mbi 30%!**

**Skandal me sallamin në
dyqanet Conad, thirrje
konsumatorëve ta kthejnë
mbapsht**

**6 milionë euro të Startup
Albania: Përfituesit, qokat
dhe "problematicët"**

Na ndiq

Facebook

Instagram

ndërsa kërkesat për ndërmjetësim dhe shtyrjen e afatit janë rrëzuar. Masa e vetme e pranuar është ajo e përkohshme për ruajtjen e status quo-së deri në konstituimin e tribunalit të arbitrazhit.

YouTube

TikTok

Në përfundim, MIE deklaroi se vendimi i mundëson ministrisë të përgatisë hapat e mëtejshëm që lidhen me zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit, të cilët, sipas saj, janë të nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik.

Në përputhje me vendimin e Arbitrit të Emergjencës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar se do ta informojë VIA-n se zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi.

Njoftim për media

Arbitrazhi i Emergjencës rrëzon kërkesat kryesore të VIA-s dhe nuk pranon të pezullojë zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit Më 16 shtator 2026, Arbitri i Emergjencës nxori Urdhrin në kuadër të procedurave të arbitrazhit të urgjencës të nisura nga VIA, Koncesionari sipas Kontratës së Koncesionit të Aeroportit të Vlorës.

Vendimi përbën një fitore të rëndësishme për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Arbitri i Emergjencës rrëzoi tërësisht dy nga tri kërkesat e VIA-s dhe nuk pranoi kërkesën kryesore të VIA-s, përkatësisht pezullimin e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit. E vetmja masë e urdhëruar ishte ruajtja e kufizuar dhe e përkohshme e status quo-së, derisa të konstituohet tribunali i arbitrazhit dhe të jetë në gjendje ta shqyrtojë çështjen.

Më e rëndësishmja, Arbitri rrëzoi kërkesën kryesore të VIA-s për të pezulluar si zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit, ashtu edhe zbatimin e Njoftimit për Zgjidhje, sipas kushteve të gjerësisht jashtëkontraktore të kërkuara nga VIA. Arbitri i Emergjencës ra dakord me MIE se as Kontrata, as provat e paraqitura nuk ofronin bazë të mjaftueshme ligjore për ta bërë këtë.

Si rrjedhojë, zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi. Arbitri rrëzoi gjithashtu kërkesat e VIA-s për të detyruar MIE të marrë pjesë në ndërmjetësim dhe të caktojë një ndërmjetës, si dhe për të shtyrë fillimin e arbitrazhit për dy muaj të tjerë. Rrëzimi i këtyre kërkesave konfirmon se mosmarrëveshja, në të cilën MIE do të vazhdojë të mbrojë me vendosmëri qëndrimin e saj, tani mund të kalojë menjëherë te tribunali i arbitrazhit.

I vetmi lehtësim i dhënë ishte një masë e përkohshme afatshkurtër. Arbitri i Emergjencës urdhëroi MIE që, përkohësisht, të mos ushtrojë të drejta të caktuara që lindin pas zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit. Arbitri theksoi se masa është afatshkurtër dhe do të mbetet në fuqi vetëm derisa të konstituohet tribunali i arbitrazhit dhe të jetë në gjendje ta shqyrtojë çështjen. Masa afatshkurtër nuk cenon vlefshmërinë apo efektshmërinë e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit.

Në dritën e këtyre konstatimeve, Arbitri i Emergjencës urdhëroi gjithashtu VIA-n të përballojë shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të urgjencës. Vendimi përfaqëson, pra, një dështim të qartë të VIA-s për të siguruar vendimin që përbënte thelbin e kërkesës së saj. VIA kërkoi të pengonte hyrjen në fuqi të zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit dhe të vononte fillimin e arbitrazhit nëpërmjet një procesi të zgjatur ndërmjetësimi.

Nuk arriti asnjërën prej tyre. Zgjidhja e Kontratës nuk u pezullua, kërkesat lidhur me ndërmjetësimin dhe shtyrjen e afatit u rrëzuan, dhe e vetmja kërkesë e pranuar është një masë afatshkurtër që ruan status quo-në derisa të konstituohet tribunali i arbitrazhit dhe të mund ta shqyrtojë vetë çështjen.

Vendimi i mundëson MIE të përgatisë hapat e mëtejshëm që rrjedhin nga zgjidhja e Kontratës së Koncesionit, të cilët janë të nevojshëm për të mbrojtur interesin publik, duke respektuar plotësisht masën e kufizuar dhe afatshkurtër të urdhëruar në pritje të konstituimit të tribunalit të arbitrazhit dhe të vendimmarrjes së tij për këtë çështje. Në përputhje me vendimin e Arbitrit të Emergjencës, MIE do ta njoftojë sot VIA-n se zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi.

Aeroporti i Vlorës MIE VIA

SHARE.



RRETH NESH

HOROSKOPI



Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për Media Etike

Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë
javë

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.